VENDIM
Nr.10, datë 2.4.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i	Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“ “
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“ “
Vitore Tusha	Anëtare	e	“ “
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“ “
Sokol Berberi	Anëtar	i	“ “
Admir Thanza	Anëtar	i	“ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 2.04.2010, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

OBJEKTI: Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Kujtim Puto.

BAZA LIGJORE: Neni 127/2 dhe 179/1 të Kushtetutës, si dhe nenet 8/2 dhe 9/2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi shqyrtoi kërkesën,

VËREN:

Zoti Kujtim Puto, me dekretin nr.2027, datë 26.3.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të ligjit nr.7491, datë 24.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, është zgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese për një mandat 12- vjeçar.

Nga të dhënat rezulton se gjyqtari Kujtim Puto, betimin para Presidentit të Republikës e ka bërë në datën 1.04.1998. Për rrjedhojë bazuar në nenin 179/1 të Kushtetutës, si dhe në nenin 8/3 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, data 1.04.2010 konsiderohet edhe si datë e mbarimit të mandatit të tij si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 127/2 të Kushtetutës, si dhe nenit 9/2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Të deklarojë mbarimin e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Kujtim Puto, në datën 1.04.2010.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarë: Fehmi Abdiu, Vladimir Kristo (kryetar), Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Admir Thanza, Sokol Sadushi